

2024-10-14 All day

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelistit, i përbërë nga Sokol Çomo kryesues, Rezarta Schuetz raportuese, Albana Shtylla, Ina Rama, Natasha Mulaj anëtare, shpalli vendimin për çështjen nr. 46/2021, datë 23.08.2021, që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Luveda Dardha kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 398, datë 11.06.2021.

Në përfundim të gjykimit në dhomë këshillimi, trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në mënyrë unanime, vendosi:

– Lënien në fuqi të vendimit nr. 398, datë 11.06.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Luveda Dardha.

– Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 14.10.2024.

Dite vendimi ([https://kpa.al/event\\_category/dite-vendimi/](https://kpa.al/event_category/dite-vendimi/))

## Related upcoming events

### **Njoftim vendimi ([https://kpa.al/?ecwd\\_event=njoftim-vendimi-250/](https://kpa.al/?ecwd_event=njoftim-vendimi-250/))** **2024-10-22 All day**

Kolegji i Posaçëm i Apelistit zhvilloi sot, më datë 07.10.2024, ora 10:00, seancën gjyqësore publike të çështjes (JR) 56/2023, datë 01.12.2023, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 703, datë 28.09.2023, që lidhet me subjektin e rivlerësimit Suela Salavaçi.

Gjatë paraqitjes së konkluzioneve përfundimtare, Komisionerja Publike deklaroi se edhe gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Kolegji, subjekti i rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi, nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë profesional.